



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Nr. 2024 prot.

Datë 22.04.2024

VENDIM

Nr. 04 datë 19.04.2024

PËR MIRATIMIN E NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 17,56 dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB, Nr. 33 datë 28.07.2023 neni 27. Kryesia e këshillit në mbledhjen e datës 19.04.2024

VENDOSI:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e Këshillit Bashkiak e cila do të mbahet më datë 26.04.2024.
2. Ngarkohet sekretari këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet sekretari këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës si dhe materialet relevante të mbledhjes tek secili këshilltar, tek kryetari Bashkisë, deputetët e qarkut, tek personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltarë dhe tek kryetari Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Mirza Miroslav

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Viktor Gjicaj

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Oliver

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Oliver Memushaj
Oliver





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

LËNDA; BASHKËLIDHUR VENDIMIT NR 4, DATË 19.04.2024, MIRATUAR NGA KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK NË MBLEDHJEN E DATËS 13.04.2024 “ PËR MIRATIMIN PARAPARAK TË RENDIT TË DITËS DHE PËRCAKTIMIN E DATËS SË MBLEDHJES PËR KËSHILLIN BASHKIAK, MUAJI PRILL 2024”.

Kryesia e këshillit vendosi se mbledhja e muajt prill do të mbahet më datë 26.04.2024, ora 10:30, me rend dite si më poshtë;

1. Shqyrtimi i kërkesës së këshilltarëve protokolluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak më datë 05.04.2024, “ Ku janë të thirrur firmat e pastrimit REJ SH.P.K dhe ALKO IMPEX SH.P.K për të dhënë informacion mbi masat e marra për fshatrat e Bashkisë Himarë për vitin 2024 ,si dhe pyetje ,diskutimi rreth mirëmbajtjes së pastrimit në territorin e Bashkisë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës nga grupi i këshilltarëve të Koalicionit Bashkë Fitojmë në lidhje me temën “Për kalimin e ujësjellësit Himarë me shoqërinë rajonale ujësjellës – kanalizime Sh.A”.
3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozim për dhënie e ndihmës ekonomike për periudhën 1 – 31 mars 2024, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok – ndihmës ekonomike”.

Sekretari
Elena Memushaj

